

Vendim nr. 218, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 23 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AFRIM KILA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2023-2585) 408, datë 19.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; nr. 1968/30-2023-6986, datë 23.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1358, datë 11.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ose në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

BAZA LIGJORE: **Nenet 29, 30, 31, 32, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. 2474/2020 për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”, të parashikuar nga neni 88, paragrafi 1, i Kodit Penal (*KP*), në ngarkim të disa shtetasve, përfshirë kërkuesin, për një ngjarje të ndodhur në datën 06.12.2020 në Ishëm, ku për shkak të një konflikti midis familjeve Kila dhe Ademi mbetën të plagosur disa shtetas dhe si pasojë, në datën 12.12.2020 shtetasi D.P.K. ka ndërruar jetë në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.

2. Gjatë hetimit paraprak janë kryer akte ekspertimi mjeko-ligjore për shtetasit e përfshirë në konflikt, përfshirë aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr. 681, datë 18.01.2021 mbi shtetasin D.P.K. që ka humbur jetën, në të cilën është konkluduar për shkakun e vdekjes së viktimës: *“Kontuzion i kokës dhe gjoksit. Kontuzion hemorragjik i trurit. HSA. Edem e trurit. Plagë në kokë. Ekimioza e dërmishje. Në trupin e kufomës [...] u konstatuan nga jashtë plagë të përpunuara kirurgjikale në kokë dhe fytyrë, ekimioza, dërmishje sipas lokalizimeve dhe karakteristikave të përshkruara në akt. Nga brenda u konstatua kontuzion hemorragjik i trurit. Dëmtimet e mësipërme janë shkaktuar me mjet të fortë mprehtës. Vdekja e shtetasit ka ardhur nga kontuzion hemorragjik i rëndë i trurit”*. Janë administruar skeda e vdekjes dhe kartela klinike të tij, si dhe procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe tabela fotografike, nga ka rezultuar se nuk janë evidentuar gjurmë frenimi, por skarcimi. Është kryer këqyrja e automjetit të përfshirë në ngjarje, nga ka rezultuar se në xhamin e parë, krahu i majtë, vërehet thyerje me goditje, xhami ka plasaritje në të gjithë sipërfaqen e tij, copa xhami në brendësi të automjetit dhe fije floku në pjesën e përparme të xhamit të dëmtuar, afër tavanit të këtij automjeti. Sipas aktit të ekspertimit biologjik ADN nr. 9096, datë 15.09.2021, është konkluduar se nga mostra e përgatitur (disa fije si ato të flokëve) u përftua profil gjenetik human i pjesshëm, i pavlefshëm për krahasime të mëtejshme. Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se automjeti i mësipërm është blerë nga kërkuesi në datën 22.10.2020. Është

administruar akti i ekspertimit auto-teknik i kryer nga tre ekspertë, nga i cili ka rezultuar se drejtuesi i automjetit ka qenë mbi normën e lejuar të shpejtësisë, në anën e gabuar të rrugës, se viktimë (këmbësor) nuk ka qenë në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe se automjeti ka qenë në gjendje të rregullt të teknike. Gjithashtu, janë pyetur personat nën hetim dhe personat që kanë pasur dijeni për ngjarjen.

3. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. (11-2023-2585) 408, datë 19.05.2023 ka vendosur deklarinë fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe e ka dënuar atë me 18 vjet burgim.

4. Ajo gjykatë ka arsyetuar lidhur me elementet e figurës së veprës penale në ngarkim të kërkuesit. Për sa i përket objektit të veprës penale, sipas asaj gjykate, është provuar se viktimë D.P.K. ka ndërruar jetë në datën 12.12.2020 në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. Në lidhje me anën objektive të kësaj figure të veprës penale, ka rezultuar e provuar se në datën 06.12.2020, rreth orës 19.00, disa shtetas kanë qenë fillimisht të ulur në lokalin e shtetasit I.Xh. dhe gjatë kohës që kanë qëndruar në lokal ka shkuar edhe shtetasi A.G., lidhje familjare e tyre, dhe u ka përcjellë mesazhin se me porosi të kërkuesit duhet të mbaronin çfarë kishin porositur dhe të largoheshin. Ky fakt, sipas gjykatës, provohet nga leximi i deklaramëve të shtetasve A.G. dhe A.K., të dhëna gjatë hetimit paraprak. Këto deklarime përputhen plotësisht edhe me deklarinët e shtetasve S.A., E.A. dhe të të pandehurit R.A. Nga deklarinët e të gjithë këtyre shtetasve, sipas gjykatës, provohet se ka qenë kërkuesi ai që i ka çuar mesazh për t’u larguar nga lokali familjes me të cilën ndodhej edhe viktimë,. Madje nga deklarinët e dëshmitarëve gjykata ka vlerësuar se provohet fakti se kërkuesi ka qenë i pranishëm në ambientet e këtij lokali së bashku me nipin e tij Xh.K., gjithashtu i pandehur. Ndërsa kërkuesi ka pretenduar se prania e tij ka qenë rastësore, pasi ai është njoftuar nga i nipi se ishte plagosur. Kjo alibi e tyre rrëzohet, sipas gjykatës, nga dëshmitë që janë dhënë në atë gjykim. Nga disa deklarime të personave që kanë dijeni për ngjarjen, gjykata është bindur se alibia e kërkuesit është dhënë e tillë qëllimisht për të fshehur ngjarjen e vërtetë dhe faktin se ai ka qenë i pranishëm jashtë lokalit. Deklarinët e shtetasit A.G. gjykata i ka çmuar me rëndësi, në përputhje me deklarinët e shtetasve të tjerë që nuk janë proceduar për këtë ngjarje, si dhe jo të njëanshme, duke qenë se ai ishte lidhje e të dy familjeve deklarime. Ndërkohë, deklarinët e kërkuesit dhe nipit të tij janë marrë me rezervë nga gjykata, për shkak se ata ishin të pandehur,

rrjedhimisht të njëanshëm. Në vijim, konflikti midis dy grupeve është zhvendosur në një tjetër lokal, aty ku palët janë konfliktuar fizikisht. I pandehuri R.A. ka goditur i pari shtetasin Xh.K., nipi i kërkuesit. Pasi janë shpërndarë, D.P.K. (viktima) është larguar drejt shtëpisë së tij dhe rrugës është goditur nga një makinë. Shtetasi A.K. është paraqitur në polici, ku ka deklaruar se viktima është goditur nga makina që drejtohej nga kërkuesi dhe se ai ka ndërruar jetë si pasojë e dëmtimeve të marra në konfliktin e ndodhur, por njëkohësisht edhe si pasojë e përplasjes të qëllimshme, sipas tij, nga kërkuesi, i cili, më pas, e ka fshehur atë. Pas gjetjes së automjetit, policia ka verifikuar se ai i përkiste kërkuesit.

5. Për sa i përket lidhjes shkakësore, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se viktima është goditur nga automjeti që drejtohej nga kërkuesi dhe se nga kjo goditje ka ndërruar jetë disa ditë më pas në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. Sipas saj, edhe pse ka kaluar një periudhë prej 6 ditësh nga përplasia deri në vdekjen e viktimës, provohet se shkak i vdekjes të të ndjerit është goditja nga automjeti, referuar aktit të ekspertimit mjeko-ligjor. Të pyetur në gjykim në cilësinë e dëshmitarëve, mjekët Y.R. dhe R.K. kanë deklaruar se kanë konstatuar te viktima shembje dhe dëmtime karakteristike të një aksidenti. Nga deklaratimet e dëshmitarëve provohet se pas konfliktit viktima ka qenë në gjendje të mirë, pasi ka qenë duke lëvizur si këmbësor për të shkuar në shtëpi. Gjatë rrugës është përshëndetur dhe ka biseduar me banorët e zonës. Pavarësisht se vdekja e të ndjerit nuk ka ardhur në mënyrë të menjëhershme, pas goditjes me makinë, pasoja e kësaj vepre penale ka ardhur nga veprimet e kërkuesit. Provohet plotësisht se midis veprimeve të kryera nga kërkuesi dhe pasojës së ardhur ka një lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë. Vepra penale do të quhet e konsumuar jo në momentin e ushtrimit të dhunës, por në momentin e ardhjes së pasojës.

6. Për sa i përket anës subjektive, gjykata e shkallës së parë ka krijuar bindjen se konflikti nuk ka qenë rastësor, por se ka pasur motiv të dobët xhelozie nga ana e kërkuesit, i cili ka qenë i interesuar për vajzën e pronarit të lokalit. Pretendimin e kërkuesit se vdekja e viktimës ka ardhur si rrjedhojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor prej tij, me pasojë vdekjen, e për këtë arsye vepra penale do të duhet të kualifikohej si shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar, pasi, sipas saj, kërkuesi ka përdorur makinën si mjet të kryerjes së veprës penale të vrasjes me dashje. Në lidhje me mekanizmin e ndodhjes së aksidentit, në aktin e ekspertimit auto-teknik të përgatitur nga tre ekspertë, është konkluduar se drejtuesi i automjetit në momentin e aksidentit ka qenë mbi normat e lejuara të kufizimit të shpejtësisë, se në momentin e

goditjes ai nuk ka qenë i pozicionuar në korsinë e krahut të djathtë e si rezultat ka goditur këmbësorin (të ndjerin), se nuk janë evidentuar shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorit. Në këto kushte, ajo gjykatë ka vlerësuar se ka qenë kërkuesi ai që ka dalë nga korsia e tij e ka hyrë në korsinë e krahut të majtë të karrexhatës, duke goditur viktimën nga pas.

7. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pasoja nuk ka ardhur nga pakujdesia, pasi kërkuesi ka qenë me shpejtësi mbi atë të lejuar në atë zonë, por edhe pse ka pasur fushëpamje të kufizuar, në një rrugë me kthesë, natën, me kushte atmosferike jo të favorshme, nuk ka marrë asnjë masë për të rregulluar shpejtësinë, në raport me fushëpamjen, që ka qenë e kufizuar. Kërkuesi ka qenë banor i zonës, ka njohur karakteristikat e rrugës, por duke përfituar nga shpejtësia e lartë, ka realizuar qëllimin kriminal. Nga procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes është konstatuar se nuk janë evidentuar gjurmë frenimi, por skarcimi, që përputhet edhe me deklaratimet e të pandehurit Xh.K., nipi i kërkuesit, pasagjer në automjet, i cili ka deklaruar se makina ka frenuar pas goditjes. Automjeti ka qenë në gjendje të rregullt teknike, çka do të thotë se nuk ka pasur shkaqe të tjera që kanë çuar në këtë goditje. Për sa i përket aktit të ekspertimit auto-teknik të kryer nga vetë kërkuesi, lejuar si provë në gjykim, ajo gjykatë ka vlerësuar se konkluzionet e tij nuk mbështeten në asnjë provë tjetër ose indicie dhe se ai akt është i njëanshëm e më pak i besueshëm se akti i kryer nga tre ekspertët. Në vijim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se edhe pse kërkuesi ka dërguar në spital viktimën, ky veprim është kryer për të ngritur alibinë se vdekja ka ardhur nga pakujdesia, si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Këtë qëndrim gjykata e bazon edhe në rrethanën e provuar se kërkuesi e ka fshehur automjetin pas ngjarjes. Nisur nga gjendja e rënduar e kërkuesit, nga fakti se kishte marrë të plagosur nipin e tij në automjet, se kishte marrë dijeni për plagosjen e të afërmit tjetër E.K., nisur nga rrethanat në të cilat është zhvilluar konflikti, mekanizmi i ngjarjes, intensitetit i goditjes, dëmtimet e rënda që ka marrë i dëmtuari, si dhe nga tërësia e provave të marra në gjykim, ka rezultuar se synimi i kërkuesit nuk ka qenë dëmtimi i shëndetit, por marrja e jetës. Si rrjedhojë, sipas gjykatës, nuk jemi as para veprës penale të plagosjes së rëndë me dashje, por të vrasjes me dashje, indirekte, pasi kërkuesi ka parashikuar ardhjen e pasojës, nuk e ka dëshiruar atë, por me ndërgjegje ka lejuar ardhjen e saj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, ndër të tjerë, kërkuesi.

8. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1968/30-2023-6986, datë 23.11.2023, me ndryshimin e uljes së dënimit për kërkuesin në 16 vjet burgim.

9. Gjykata e apelit ka çmuar se provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm akuza e ngritur ndaj kërkuesit për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje, duke e gjetur kështu të pabazuar pretendimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Ajo gjykatë ka arsyetuar se nga tërësia e provave të administruara, rezulton i provuar mekanizmi i ngjarjes, si dhe fakti se konflikti është iniciuar për motive të dobëta xhelozie nga ana e kërkuesit. Në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit ka krijuar bindjen tej çdo dyshimi se kërkuesi e ka goditur me dashje direkte të ndjerin, duke synuar marrjen e jetës së tij. Të dhënat nga provat shkencore, sipas saj, vijnë në harmoni dhe konfirmojnë vërtetësinë e deklarimeve të të pandehurit R.G., i cili ka qenë në shoqërinë e viktimës në momentin e aksidentit, kur ka deklaruar se kërkuesi e ka përdorur automjetin si mjet për kryerjen e vrasjes. Në kushte të tilla, sipas gjykatës së apelit, nuk gjenden të drejta pretendimet se iu është dhënë vlerë e paracaktuar deklarimeve të këtij shtetasi. Ajo gjykatë ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se sjellja e kërkuesit pas kryerjes së veprës penale, ku e ka marrë viktimën me automjet dhe e ka transportuar në qendrën shëndetësore, ka qenë në funksion të alibisë së tij, me qëllimin për të zbutur përgjegjësinë penale. Veprimi i fshehjes së automjetit pas kryerjes së veprës penale, i shërben pikërisht alibisë së paramenduar për ta konsideruar veprën aksident, duke pamundësuar kështu këqyrjen e automjetit dhe verifikimin e dëmtimeve, të cilat qartazi përcaktojnë pikën e goditjes së mjetit me viktimën dhe vërtetojnë, në bindjen e asaj gjykate, qëllimin e kërkuesit për të vrarë viktimën. Pretendimin në lidhje me ndërprerjen e lidhjes shkakësore, për shkak se të ndjerit nuk iu dha ndihma mjekësore nga personeli shëndetësor Ishëm, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar në përfundimet e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor. Akti i ekspertimit mjeko-ligjor, sipas asaj gjykate, provon katërcipërisht se shkak i vdekjes është kontuzioni hemorragjik i rëndë i trurit, si pasojë e dëmtimeve të shkaktuara me mjet mprehës, duke konfirmuar kështu lidhjen shkakësore mes përplasjes me automjet të viktimës nga kërkuesi dhe pasojës, vdekjes së viktimës. Nga akti në fjalë nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie se vdekja e të ndjerit mund të ketë ardhur nga mosdhënia e ndihmës mjekësore, për më tepër që i ndjeri është transportuar menjëherë për në Spitalin e Traumës në Tiranë, pra nuk është mbajtur për mjekim në qendrën shëndetësore Ishëm.

10. Në lidhje me pretendimin për shkelje procedurale, pasi në seancën e datës 19.05.2023 janë legjitimuar në mbrojtje të kërkuarit 4 avokatë në shkelje të nenit 48 të KPP-së, ai nuk rezulton i drejtë sipas gjykatës së apelit. Seanca e referuar rezulton të jetë seanca e pretendimeve përfundimtare, ku kërkuari është mbrojtur nga avokatja E.N., avokate zëvendësuese me autorizim të studios ligjore të zgjedhur nga kërkuari, ndërkohë që kryesisht për atë seancë është caktuar avokatja E.P., pasi është revokuar vendimi për avokatin e mëparshëm. Pra, në mbrojtje të kërkuarit kanë vepruar 2 avokatë, në përputhje edhe parashikimet e nenit 48 të KPP-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuari.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2025–1358, datë 11.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në të nuk janë nga ato që përcaktohen në nenin 432 të KPP-së. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ato shkaqe, në thelb, përqendrohen te bazueshmëria dhe provueshmëria e fajësisë së tij për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe se Gjykata e Lartë kontrollon vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm në drejtim të zbatimit të ligjit material dhe procedural penal. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se është në kompetencën e saj të shqyrtojë brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs nëse nga gjykatat më të ulëta është zbatuar drejt ligji dhe nëse vendimmarrja e tyre është në standardet e një vendimmarrjeje të arsyetuar. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs kanë marrë përgjigje të plotë përmes vendimmarrjes së gjykatave të faktit, të cilat kanë analizuar në mënyrë të detajuar pretendimet e organit të akuzës dhe të kërkuarit, në raport me provat e faktet e paraqitura dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe ligjin e zbatueshëm dhe se rekursi nuk rezulton që të përmbajë shkaqe që cenojnë vendimin e kundërshtuar. Lidhur me pretendimin për kualifikimin ligjor të faktit penal që i është atribuar kërkuarit, duke pretenduar se nuk ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, por se ka konsumuar elementet e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290 i KP-së, arsyetimi i gjykatave më të ulëta është konsideruar i plotë dhe shterues nga Gjykata e Lartë. Në këtë pikë, ajo gjykatë ka perfrazuar vlerësimin e gjykatës së apelit. Në lidhje me analizën e elementeve të veprës penale, konkretisht, anës objektive e subjektive të veprës penale, sipas saj, gjykata e apelit i ka analizuar ato me hollësi në pjesën arsyetuese të vendimit, duke i dhënë secilit element argumente ndërlidhëse, si në anën ligjore, ashtu edhe faktike të veprimeve të kërkuarit. Gjykata ka krijuar bindjen e saj të brendshme, duke

marrë në harmoni të gjitha elementet e veprës penale, në veçanti ndikimin e anës objektive dhe të anës subjektive, në përcaktimin e saktë të cilësimit ligjor të veprës penale në ngarkim të të pandehurit.

12. Për sa i përket pretendimit të cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur nga avokati i zgjedhur dhe së drejtës për të gëzuar mbrojtje efektive, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka argumentuar mjaftueshëm pabazueshmërinë e këtij pretendimi, duke perifrazuar vlerësimin e saj edhe në këtë pikë. Konkretisht, ajo gjykatë ka evidentuar se sipas gjykatës së apelit, në seancën gjyqësore të datës 15.05.2023 në gjykatën e shkallës së parë, nga procesverbali i seancës ka rezultuar se ka qenë i pranishëm edhe avokati L.P., i zgjedhur nga kërkuesi, i cili është shprehur se ishte njohur me aktin e ekspertimit (dhe nuk ka pretenduar të kundërtën) dhe u ka drejtuar vazhdimisht pyetje ekspertëve lidhur me konkluzionet e atij akti. Në përfundim të seancës, gjykata e shkallës së parë ka deklaruar përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe ka ftuar palët të paraqesin pretendimet përfundimtare, ndërsa vetëm përfaqësuesi i akuzës ka kërkuar kohë për t'i përgatitur ato me shkrim. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për në datën 17.05.2023, në të cilën ka qenë i pranishëm edhe avokati L.P. i zgjedhur nga kërkuesi. Në atë seancë është mbyllur shqyrtimi gjyqësor i çështjes dhe është kaluar në pretendimet përfundimtare të prokurorit dhe ndonëse nuk është formuar trupi gjykues, për ekonomi gjyqësore gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të depozitoheshin pretendimet përfundimtare të prokurorit, duke ju dhënë kopje palëve për t'u njohur, ndërkohë që leximi i tyre dhe i konkluzioneve të avokatëve do të bëhej në seancën e caktuar paraprakisht të datës 19.05.2023. Gjatë kësaj të fundit, avokati L.P. ka deklaruar se nuk i kishte gati pretendimet përfundimtare dhe ka kërkuar kohë, ndërkohë që të gjitha palët e tjera i kanë paraqitur ato. Në këtë situatë gjykata e shkallës së parë ka vendosur të mos e pranojë kërkesën për shtyrje dhe ta konsiderojë atë si abuzive, me arsyetimin se seanca ishte caktuar me pëlqimin e të gjitha palëve; se avokatit L.P. i ishin vënë në dispozicion konkluzionet e prokurorit që në seancën e kaluar, në të cilën u la detyrë që të gjitha palët të ishin të përgatitura për këtë seancë; se për avokatin tjetër (E.H.) të kërkuesit nuk u provua që nuk kishte mundësi të përgatiste diskutimet përfundimtare për atë seancë. Pavarësisht këtij vlerësimi, gjykata i ka lënë kohë deri në orën 14:00 të asaj dite për të dëgjuar konkluzionet, duke caktuar njëkohësisht edhe një avokat kryesisht për kërkuesin, në rast se avokati i zgjedhur nuk do të paraqitej. Pas riçeljes së seancës gjyqësore, ajo gjykatë ka verifikuar prezencën e palëve dhe ka rezultuar se avokati i

zgjedhur nga kërkuesi nuk ishte paraqitur dhe as avokati i caktuar kryesisht, i cili kishte lajmëruar sekretarinë gjyqësore se ndodhej jashtë shtetit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur të ndërpresë seancën për disa minuta në mënyrë që avokatja E.N., e asociuar pranë studios ligjore të avokatit L.P., të paraqiste përpara trupit gjykues prokurën e përfaqësimit. Pas riçeljes së seancës, është revokuar vendimi për caktimin e avokatit kryesisht, duke qenë në pamundësi paraqitjeje dhe është caktuar avokatja E.P. si avokate kryesisht, ndërkohë që prezent ka qenë edhe avokatja E.N., e cila ka depozituar pretendimet përfundimtare në 37 fletë.

13. Për sa më sipër, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se nuk ishin të bazuara pretendimet për mosnjohjen dhe pamundësinë për të diskutuar në gjykim rreth konkluzioneve të aktit të ekspertimit auto-teknik, si dhe ato për cenimin e së drejtës së kërkuesit për të zgjedhur avokatin e tij dhe së drejtës për të pasur një mbrojtje efektive. Në vlerësimin e saj, rezulton se në seancat gjyqësore që nuk kanë qenë të pranishëm avokatët e zgjedhur (mungesë e pajustificuar) është proceduar me caktimin e avokatëve kryesisht, për të mos u bërë pengesë për gjykimin dhe në kushtet kur nuk ka pasur papajtueshmëri të interesave. Duke mbajtur në konsideratë shkaqet e rekursit në tërësi, si dhe në referim të rrethanave dhe fakteve të paraqitura si të provuara nga gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimmarrjen e tyre, qoftë për sa i përket kualifikimit ligjor të faktit penal të atribuar ndaj kërkuesit, ashtu edhe drejtim të provueshmërisë së fajësisë së tij, për kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar.

14. Në datën 10.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave ligjore, është regjistruar më 24.03.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

15. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

15.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë të patrajtuara një sërë pretendimesh të ngritura nga kërkuesi, si ai në lidhje me mungesën e elementeve objektive dhe subjektive të

veprës penale që i është atribuar. Në rastin konkret prokuroria dhe gjykatat për të konkluduar rreth ekzistencën së dashjes direkte u janë referuar disa elementeve të përgjithshme të anës objektive, të cilat tregojnë dashjen e kërkuesit për të shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, por jo dashjen për ardhjen e pasojës. Kërkuesi ka tentuar të frenojë makinën dhe kjo rezultoi edhe nga akti i ekspertimit të paraqitur nga ai. Ndërkohë, motivi i xhelozisë është një fabul e ndërtuar mbi bazën e dëshmive që ngarkojnë kërkuesin me përgjegjësi, duke i dhënë vlerë të paracaktuar atyre. Gjithashtu, në shkelje të nenit 380 të KPP-së, gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të kërkuesit bazuar në shkresën nr. 553, datë 05.05.2023 të Drejtorisë së Policisë Vendore Durrës, e cila nuk është administruar në dosje, shkelje që duhet të sillte si pasojë prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykatat më të larta. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje as pretendimeve që lidhen me shkeljen e parimit të paanshmërisë në gjykim dhe prezumimit të pafajësisë së kërkuesit.

15.2. *Së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë kryer një sërë shkeljesh procedurale, të cilat nuk janë konstatuar as nga gjykata e apelit dhe as nga Gjykata e Lartë, që konsistojnë në sa vijon:

15.2.1. Diskutimi mbi aktin e ekspertimit auto-teknik dhe pyetja e ekspertëve në seancë gjyqësore janë zhvilluar ndërkohë që kërkuesi dhe avokatët e tij L.P. dhe E.H. nuk ishin njohur me aktin e ekspertimit. Ky akt është dërguar të premtën, ndërsa seanca e radhës ka qenë ditën e hënë, në të cilën dhe ka mbërritur akti. Ajo gjykatë e ka konsideruar të përmbushur detyrën e saj me nisjen e aktit me postë, duke anashkaluar faktin se kur kishte mbërritur te marrësi. Kërkesa e mbrojtësit për të shtyrë seancën është konsideruar nga gjykata si abuzive. Për rrjedhojë, është cenuar edhe parimi i barazisë së armeve dhe kontradiktoritetit.

15.2.2. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë kohën e domosdoshme avokatit të kërkuesit për të përgatitur mbrojtjen në seancën e bisedimeve përfundimtare (48 orë për një hetim që ka zgjatur pothuajse 3 vjet). Pavarësisht se kërkuesi u ka dhënë tagrat e përfaqësimit dy avokatëve, mbrojtja është kryer vetëm nga avokati L.P. Për më tepër, çdo vendim ose urdhër i marrë gjatë seancës së datës 17.05.2023 është i pavlefshëm,

pasi nuk janë respektuar rregullat procedurale në lidhje me numrin e gjyqtarëve për formimin e kolegjit. Në seancën e datës 19.05.2023 avokati tjetër i kërkuesit ka kërkuar shtyrjen e seancës, pasi nuk ka pasur mundësi objektive për të përgatitur konkluzionet, por kërkesa është konsideruar abuzive nga gjykata, e cila i ka lënë afat vetëm 2-3 orë për paraqitjen e tyre me shkrim. Duke qenë e vetëdijshme për afatin shumë të shkurtër të lënë në dispozicion, në të njëjtën seancë gjykata i ka caktuar edhe avokat kryesisht kërkuesit, duke arsyetuar se avokati kryesisht ishte caktuar për situatën që avokati i zgjedhur nuk do të paraqiste pretendimet përfundimtare në afat.

15.2.3. Ajo gjykatë nuk ka marrë masa për t'i njoftuar kërkuesit zëvendësimin e avokatit të zgjedhur prej tij me një avokat të caktuar kryesisht. Në këtë situatë gjykata e shkallës së parë nuk duhej të kishte caktuar një avokat kryesisht për kërkuesin, po duhej të kishte njoftuar avokatin tjetër (të dytë) të zgjedhur nga ai, duke e njoftuar edhe kërkuesin për këtë. Rastet e caktimit të avokatit kryesisht janë të përcaktuara në nenin 49 të KPP-së, ndërsa kur avokati nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme, ai nuk zëvendësohet në mënyrë të menjëhershme nga gjykata, por ajo procedon në bazë të nenit 350 të KPP-së, duke gjobitur avokatin.

15.2.4. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 55 të KPP-së në lidhje me revokimin dhe zëvendësimin e avokatit. Pavarësisht se i është caktuar një avokat kryesisht, gjykata sërish ka thirrur në seancë një tjetër avokat kryesisht (avokaten E.Th.), që për një kohë prej 1-2 orësh ka deklaruar në seancë se është njohur me aktet e hetimeve dhe të gjykimit dhe madje kishte përgatitur edhe pretendimet përfundimtare. Në këtë pikë nuk është e qartë si dhe kur është marrë vendimi për zëvendësimin e avokatit kryesisht.

15.3. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, për shkak të sjelljes dhe qëndrimeve të mbajtura gjatë gjykimit në shkallë të parë në lidhje me kërkesat e palëve. Fillimisht, gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar se seancat gjyqësore do të mbaheshin çdo dy javë, mirëpo me zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “Arresti në burg” me “Arresti në shtëpi”, për shkak të konsumimit të afateve të paraburgimit, gjykata i ka zhvilluar seancat çdo javë, madje edhe dy herë në javë, duke zhbërë marrëveshjen që kishte me palët. Ky ndryshim i sjelljes pas ndryshimit të masës së sigurimit e komprometon

gjykatën. Trupi gjykues e ka perceptuar konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit si një përfitim të padrejtë të kërkuesit, duke i dhënë fund sa më parë me një vendim fajësie. Në mbështetje të këtij fakti është edhe argumenti se gjykata e ka dënuar kërkuesin me një dënimin më të lartë se ai i kërkuar nga prokurori, duke e rivënë në fuqi paraburgimin për kërkuesin, ndërkohë që nuk kishte kërkesë nga prokurori dhe nuk ia kishte nënshtruar këtë debatit gjyqësor. Kjo shkelje procedurale u konstatua nga gjykata e apelit, e cila, me vendimin e datës 16.08.2023, vendosi të shfuqizojë vendimin nr. (11-2023-2585) 408, datë 19.05.2023 në lidhje me disponimin për rivënien në fuqi të masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Në mbështetje të këtyre konsideratave janë edhe shkeljet e shumta procedurale që ka konsumuar gjykata e shkallës së parë, motivimin e vendimmarrjes duke u bazuar vetëm në dëshmitë që ngarkojnë me përgjegjësi penale kërkuesin, si dhe arsyetimi i mangët në drejtim të të provuarit të fajësisë së tij për veprën penale të vrasjes me dashje. Megjithatë kërkuesi i ka ngritur këto pretendime si në ankim dhe në rekurs, as gjykata e apelit, as Gjykata e Lartë nuk kanë dhënë asnjë përgjigje në këtë drejtim.

15.4. *Parimit të mosdënimit pa ligj*, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi cilësimi juridik i pranuar nga gjykatat lidhur me faktin penal në ngarkim të kërkuesit është i gabuar dhe nuk u përgjigjet rrethanave të faktit dhe provave, për sa kohë kemi të bëjmë me një akt të kryer me pakujdesi. Pra, kërkuesi duhet të ishte dënuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe jo për vrasje me dashje. Sjellja e kërkuesit është e tillë që përjashton ekzistencën e elementit subjektiv të dashjes për veprën për të cilën është dënuar. Për më tepër, përkeqësimi fatal i gjendjes së viktimës është ndikuar edhe nga mungesa e kushteve minimale të trajtimit mjekësor në qendrën shëndetësore Ishëm, rrethanë e cila është trajtuar në mënyrë sipërfaqësore nga gjykatat.

15.5. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, për shkak të shkeljeve procedurale të lejuara në gjykimin në shkallën e parë, si dhe referimit nga gjykatat e faktit vetëm në provat që ngarkonin me përgjegjësi penale kërkuesin, duke neglizhuar provat që vërtetojnë se ngjarja ka qenë aksident. Në këtë kuptim, prokuroria dhe gjykatat nuk e kanë përmbushur standardin e të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Përgjegjësia e kërkuesit për veprën për të cilën është dënuar është një

prezumim faktik i diskutueshëm në kushtet kur: i) shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nuk vërteton automatikisht dashjen në ardhjen e pasojës; ii) kërkuesi ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për të shmangur përplasjen; iii) pas përplasjes e ka transportuar viktimën drejt qendrës shëndetësore; iv) midis viktimës dhe kërkuesit nuk ka pasur asnjë lloj konflikti; v) motivet për të cilat pretendohet se ka lindur konflikti përpara aksidentit janë të pabazuara; vi) pavarësisht përpjekjes së kërkuesit që viktima të merrte ndihmën mjekësore, në qendrën shëndetësore mungonin kushtet minimale për të dhënë një ndihmë mjekësore të kualifikuar. Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të ishte dënuar për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor dhe jo për veprën e vrasjes me dashje.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

16. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të

zakonshtëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.09.2025 dhe u është njoftuar avokatëve të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 14.11.2026, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 10.03.2026, pra brenda afatit 4-mujor.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, së drejtës për mbrojtje efektive, parimit të paanshmërisë në gjykim, parimit të mosdënimit pa ligj dhe atij për prezumimin e pafajësisë.

19. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, Kolegji vëren se kërkuesi për të provuar njëanshmërinë e gjykatës në procesin e kundërshtuar, ka sjellë si argument vendimmarrjet e gjykatave lidhur me masën e sigurimit personal të vendosur ndaj tij. Konkretisht, sipas kërkuesit, gjykata e shkallë së parë ka rivënë në fuqi paraburgimin për kërkuesin, ndërkohë që nuk kishte kërkesë nga prokurori dhe kjo shkelje procedurale është konstatuar nga gjykata e apelit. Po kështu, sipas kërkuesit, gjykata e ka gjykuar çështjen me një ritëm shumë të shpejtë, duke caktuar një ose dy seanca në javë, më qëllim që kërkuesi të mos përfitonte nga mbarimi i afatit tërësor të paraburgimit.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre, pra që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 7, datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se mënyra sesi disponon gjykata lidhur me çdo kërkesë të palëve gjatë procesit gjyqësor është objekt kontrolli nga gjykatat më të larta dhe nuk përbën shkak njëanshmërie. Marrja e vendimeve nga gjyqtarët dhe administrimi i gjykimit prej trupit gjyqësor

janë shfaqje të çmuarjes dhe vlerësimit që i njihet gjyqtarit në gjykimin e çështjes, si shprehje e pavarësisë dhe paanësisë së tij (*shih vendimin nr. 3, datë 15.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret Kolegji vëren se vendimmarrja e gjykatave lidhur me masën e sigurimit nuk është objekt i ankimit kushtetues individual, por kërkuesi e paraqet atë si argument në drejtim të paanshmërisë së gjykatës në shqyrtimin e çështjes së themelit, prandaj do të analizohet nëse kjo vendimmarrje procedurale ose caktimi i afërt i seancave është e aftë të provojë njëanshmërinë e gjykatës në lidhje me procesin e kundërshtuar.

22. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë sesi rivendosja në fuqi e paraburgimit për kërkuesin, e shfuqizuar nga gjykata e apelit ose gjykimi me ritëm të shpejtë i çështjes, ka ndikuar në dënimin e tij, pra të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë me bindjen e brendshme ose interesin personal të gjyqtarit. Prandaj, vendimmarrja e gjykatave lidhur me zbatimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, si dhe vendimmarrja e ndërmjetme për caktimin e seancave gjyqësore, nuk duket se përbëjnë shkak njëanshmërie në gjykimin e themelit të çështjes. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

23. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për *cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive*, të mbështetur në argumentet e mosnjohjes dhe pamundësisë për të debatuar rreth konkluzioneve të aktit të ekspertimit auto-teknik ose për cenimin e së drejtës së kërkuesit për të zgjedhur avokatin e tij dhe së drejtës për të pasur një mbrojtje efektive, ai pretendim është analizuar në mënyrë të detajuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka gjetur të pabazuar në ligj (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Për më tepër, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime të natyrës së përgjithshme, pa konkretizuar se në ç'mënyrë i është cenuar e drejta për mbrojtje, duke iu caktuar në përputhje me parashikimet ligjore edhe një avokat kryesisht nga gjykata, ose në ç'mënyrë i është cenuar e drejta për mbrojtje nga avokatja e zgjedhur nga kërkuesi, e cila ka paraqitur 37 fletë pretendime përfundimtare, ose cilat janë ato shkaqe ose argumente me natyrë ligjore ose kushtetuese që nuk janë parashtruar, ose sesi është vepruar në kundërshtim me interesat e kërkuesit, ose si nuk janë përmbushur kërkesat thelbësore procedurale. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

24. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, parimit të prezumimit të pafajësisë dhe mosdënimit pa ligj*, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me mënyrën e

zbatimit të standardit kushtetues të të provuarit të fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, sipas nenit 30 të Kushtetutës, si dhe mënyrën e arsyetimit të gjykatave të zakonshme për përcaktimin e fajësisë së kërkuesit për veprën penale për të cilën është dënuar, sipas nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë do të analizohen në këtë drejtim.

25. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjyqimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjyqimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e

mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse për sa i përket standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, në kuptim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Bazuar në vendimet gjyqësore në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë e ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje, pasi ka shqyrtuar disa prova shkencore dhe me dëshmitarë, të cilat kanë qenë në harmoni me njëra-tjetrën. Sipas asaj gjykate, në analizë të elementeve të anës objektive të figurës së veprës penale të vrasjes me dashje, në raport me faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar nga provat e administruara në gjykim, është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi, pasi është konfliktuar me familjen Ademi për motive të dobëta dhe pasi i është rënduar edhe më shumë gjendja emocionale për shkak të plagosjes së nipit në atë konflikt, ka goditur me automjet të ndjerin, me qëllimin për t'i marrë jetën dhe më pas ka fshehur automjetin. Pretendimin e kërkuesit se kemi të bëjmë me veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, ajo gjykatë e ka vlerësuar të pabazuar në prova. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar gjerësisht lidhur me anën subjektive të kërkuesit në kryerjen e veprës për të cilën është dënuar. Ajo gjykatë ka lejuar edhe prova të kërkuara nga kërkuesi, si akti i ekspertimit i përgatitur nga një ekspert i kontraktuar nga kërkuesi, për të cilin ka arsyetuar se përse e sheh si të njëanshëm dhe më të pabesueshëm se akti i ekspertimit me 3 ekspertë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar gjithashtu se përse i merr me rezervë deklaratimet e kërkuesit dhe nipit të tij, të pandehur në atë gjykim, duke shpjeguar se është bindur se alibia e kërkuesit është dhënë e tillë qëllimisht për të fshehur ngjarjen e vërtetë dhe faktin se ai ka qenë i pranishëm jashtë lokalit ditën e ngjarjes.

28. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke ulur dënimin për kërkuesin në 16 vjet burgim. Edhe ajo gjykatë ka vlerësuar se vërtetohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi e kishte kryer veprën për të cilën ishte dënuar, madje në ndryshim nga shkalla e parë, ka çmuar se dashja ishte direkte. Ajo gjykatë ka marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit, përfshirë pretendimet për kualifikimin ligjor të faktit penal, për ndërprerjen e lidhjes

shkakësore midis veprimit të kërkuesit dhe ardhjes së pasojës dhe pretendimin për shkeljen e nenit 48 të KPP-së, për shkak të caktimit të më shumë se dy avokatëve, duke i gjetur të pabazuara.

29. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit dhe ka arritur në përfundimin se ato ishin të ndryshme nga shkaqet e parashikuara në ligj, pasi në thelb përqendroheshin tek bazueshmëria dhe provueshmëria e fajësisë së kërkuesit për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte dënuar. Pavarësisht se ajo gjykatë nuk i hyn vlerësimit të provave, ka shqyrtuar brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs nëse gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin dhe nëse vendimmarrja e tyre ishte në standardet e një vendimmarrje të arsyetuar dhe ka arritur në përfundimin se pretendimet e ngritura në rekurs kanë marrë përgjigje të plotë përmes vendimmarrjes së gjykatave të faktit. Lidhur me pretendimin për kualifikimin ligjor të faktit penal që i është atribuar kërkuesit, ajo gjykatë ka qenë plotësisht dakord me arsyetimin e gjykatës së apelit, duke perifrashuar vlerësimin e saj në këtë pikë. Në lidhje me analizën e elementeve të veprës penale, konkretisht anës objektive e subjektive të veprës penale, ajo gjykatë ka çmuar se gjykata e apelit i ka analizuar ato me hollësi në pjesën arsyetuese të vendimit, duke i dhënë secilit element argumente ndërlidhëse, si në anën ligjore, ashtu edhe faktike të veprimeve të kërkuesit, pasi ka krijuar bindjen e saj të brendshme, duke marrë në harmoni të gjitha elementet e veprës penale, në veçanti ndikimin e anës objektive dhe të anës subjektive, në përcaktimin e saktë të cilësimit ligjor të veprës penale në ngarkim të kërkuesit. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur nga avokati i zgjedhur dhe së drejtës për të gëzuar mbrojtje efektive, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka argumentuar mjaftueshëm pabazueshmërinë e këtij pretendimi. Sipas asaj gjykate, ky pretendim, i mbështetur në argumentet e mosnjohjes dhe pamundësisë për të debatuar rreth konkluzioneve të aktit të ekspertimit auto-teknik ose për cenimin e së drejtës së kërkuesit për të zgjedhur avokatin e tij dhe të drejtën për të pasur një mbrojtje efektive, nuk është i bazuar (*shih paragrafët 11-13 të vendimit*).

30. Në referim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj kërkuesit, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit nuk rezulton të kenë arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e tij. Ato gjykata e kanë mbështetur vendimin për fajësinë e kërkuesit mbi analizën tërësore të provave të administruara në gjykim (shkencore dhe me dëshmitare), të pasqyruara edhe në vendim, të cilat i kanë shqyrtuar e vlerësuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, duke parashtruar në vendim edhe shkaqet mbi të cilat ato kanë arritur në

përfundimet e shprehura në dispozitiv. Gjykatat e faktit kanë analizuar edhe provat ose dëshmitarët e kërkuar nga kërkuesi dhe janë shprehur për vlerën provuese të tyre, duke e argumentuar atë. Arsyetimi i tyre është marrë në shqyrtim edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili, në ushtrim të kompetencave të tij, i ka gjetur arsyetimet të drejta dhe të bazuara, duke i konsideruar të pabazuara shkaqet e parashtruara në rekurs, si dhe ka parashtruar në vendim argumentet mbi të cilat ka bazuar qëndrimin e tij.

31. Kolegji vëren gjithashtu se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, sikundër në ankimin kushtetues individual, kërkuesi nuk ka pasur kundërshtime për mënyrën e marrjes së provave që kanë provuar fajësinë e tij për veprën për të cilën është dënuar, por pretendimet e tij kanë të bëjnë me mënyrën sesi janë vlerësuar këto prova nga gjykatat në arritjen e përfundimit për fajësinë e tij për veprën penale të vrasjes me dashje, e cila është e gabuar sipas tij, pasi ai duhej të ishte dënuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, ashtu edhe ato për vlerësimin e ligjit penal material të zbatueshëm, nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, për sa kohë që bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, nuk rezulton që ato të jenë vendime të marra nga një gjykatë e pakujdesshme ose haptazi të paarsyeshme, pra që të vënë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë.

32. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.